



Help

Hilfe zur Selbsthilfe

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V

Zyra Përfaqësuese në Kosovë

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

FAQJA

RAPORTI I AUDITORIT

BILANCI I GJENDJES

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

5 – 9



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të "Help" - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqësuese në Kosovë

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të "HELP"- Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqësuese në Kosovë, të cilat përfshin Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020, Pasqyrën e të Ardhurave, Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet, Pasqyrën e Rrjedhjes së Parasë për vitin e përmbyllur dhe të shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të "HELP"- Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqësuese në Kosovë (tash e tutje referuar si HELP) më 31 dhjetor 2020, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Ligjet aktuale ne fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjet aktuale në fuqi dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Armend Osaj- Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
Mars 2021




Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqesuese në Kosovë
Pasqyra e Pozitës Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

PASURITË	Shënimi	31 Dhjetor 2020 (ne EUR)	31 Dhjetor 2019 (ne EUR)
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe paisjet		-	-
Totali i pasurive jo-qarkulluese		-	-
Pasuritë qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	3	120,629	60,666
Totali i pasurive qarkulluese		120,629	60,666
TOTALI I PASURIVE		120,629	60,666
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme		-	-
Të hyrat e shtyera		-	-
Totali i detyrimeve afatshkurta		-	-
Kapitali			
Fitimi i mbajtur		60,666	38,490
Suficiti/(Deficiti) i periudhës		59,963	22,176
Totali i kapitalit		120,629	60,666
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		120,629	60,666


Pasqyrat financiare janë nënshkruar në Mars 2021 nga:

Shqipe Breznica


 Kordinatore



Butrint Tuzi


 Zyrtar i Financave

Shënimet e bashkëngjitura nga 1 në 10 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqesuese në Kosovë
Pasqyra e të ardhurave
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

		Fundi i vitit 31 Dhjetor 2020 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2019 (në EUR)
Të hyrat	Shënimi		
Të hyrat	4	724,973	622,899
Total te hyrat		724,973	622,899
Shpenzimet			
Shpenzimet direkte për projekte	5	458,443	395,516
Shpenzimet e personelit	6	135,412	122,841
Shpenzimet operative	7	3,000	1,558
Shpenzimet e transportit	8	25,323	40,543
Shpenzimet administrative	9	42,832	40,265
Total Shpenzimet		665,010	600,722
Neto të hyrat mbi shpenzimet		59,963	22,176

Shënimet e bashkëngjitura nga 1 në 10 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqesuese në Kosovë
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)
Gjendja fillestare më 1 Janar 2019	38,490
Deficiti/mbetja neto i fundit të vitit më 31 Dhjetor 2019	22,176
Gjendja më 31 Dhjetor, 2019	<u><u>60,666</u></u>
Gjendja fillestare më 1 Janar 2020	60,666
Deficiti/mbetja neto i fundit të vitit më 31 Dhjetor 2020	59,963
Gjendja më 31 Dhjetor, 2020	<u><u>120,629</u></u>

Shënimet e bashkëngjitura nga 1 në 10 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqesuese në Kosovë
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2020 (në EUR)	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2019 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
Fitimi/Humbja e periudhes	59,963	22,176
Rregulluar për:		
Zhvlersimin	-	-
Të hyrat e shtyera	-	-
Llogaritë e arkëtueshme	-	-
Llogaritë e pagueshme	-	-
Paratë e gjeneruara nga operacionet	59,963	22,176
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-
Paraja neto e përdorur në investime	-	-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	59,963	22,176
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	60,666	38,490
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	120,629	60,666

Shënimet e bashkëngjitura nga 1 në 10 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqesuese në Kosovë
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

1. Hyrje

Misioni "Help" në Republikën e Kosovës filloi punën gjatë fazës së emergjencës në Kosovë në vitin 2000. Pas disa viteve të ndërprerjes së aktiviteteve në Kosovë, "Help" filloi me projektin "Mbështetje për stabilitetin socio-ekonomik përmes fuqizimit të sektorit të mikro-biznesit në Kosovë " në Maj 2015.

Gjate vitit 2020 "Help" implementoni disa projekte nder to:

LUXEMBOURG – Projekti "Supporting and Promoting the well-being of persons with Down Syndrom" duke filluar nga 15 tetor 2018. Projekti fokusohet ne mbeshtetjen dhe promovimin e mireqenies per personat me sindromin Down.

EMPOWER – Projekti "Self-employment training program" perfshine periudhen 30 korrik 2018 – 31 tetor 2019. Projekti ka ne fokus te vecante nxitjen e ndermarresise tek grupe te vecanta te personave me mundesi te pakta te vetfinancimit.

2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë të kostos historike për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

2.2 Valuta e pëdorur

Valuta funksionale e Organizatës është valuta e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

2.3 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shumë se tre muaj.

2.4 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga grantet njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

2.5 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit.

2.6 Tatimet

Organizata u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

2.7 Përfitimet e të punësuarve

Organizata, në rrjedhën normale të biznesit, bën pagesa në buxhetin e shtetit për llogari të puntorëve. Puntorët e Organizatës janë anëtarë të planit shtetëror të pensioneve. Të gjitha kontributet e tilla në skemat e pensioneve të detyrueshme qeveritare shpenzohen kur ato ndodhin. Organizata nuk operon asnjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas daljes në pension dhe, rrjedhimisht, nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pensionet.

Për më tepër, Organizata nuk ka detyrime materiale për të siguruar përfitime të mëtejshme për puntorët paraprak dhe aktual.

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqesuese në Kosovë
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

3. PARAJA DHE GJENDJA NË BANKA

	31 Dhjetor 2020 (në EUR)	31 Dhjetor 2019 (në EUR)
Paraja ne banke - ProCredit bank 144	75,388	45,140
Paraja ne banke - ProCredit bank 117	12,060	60
Paraja ne banke - ProCredit bank 135	2,470	490
Paraja ne banke - ProCredit bank 153	9,965	2,667
Paraja ne banke - ProCredit bank 126	20,746	11,490
Paraja ne arke	-	819
Total Paraja dhe ekuivalentet e parasë	120,629	60,666

Gjatë kësaj periudhe Help ka pasur pesë llogari bankare të hapura në ProCredit Bank Kosovë. Llogaritë bankare janë në valutën Euro.

4. TË HYRAT

	31 Dhjetor 2020 (në EUR)	31 Dhjetor 2019 (në EUR)
Te hyra nga Bonn	528,646	364,929
Te hyrat nga Komunat	-	110,000
Te hyrat nga Perfituesit	38,599	41,270
Te hyrat nga Ministrit	-	42,000
Te hyrat nga ATK	134,400	49,000
Te hyrat Empower USAID	-	8,200
Te hyrat nga Ambasada Luxemburg	10,000	1,500
Te hyra tjera	4,790	6,000
Te hyrat nga DRC	8,539	-
Total te hyrat	724,973	622,899

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqesuese në Kosovë
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

5. SHPENZIMET DIREKTE PËR PROJEKTE

	31 Dhjetor 2020 (në EUR)	31 Dhjetor 2019 (në EUR)
SOE 01	-	9,500
SOE 03	310,993	353,799
ALB 002	38,995	16,897
KOS 001	4,712	-
KOS 028	-	8,320
KOS 030	-	7,000
KOS 031	42,022	-
XKX 035	8,539	-
XKX 036	48,593	-
XKX 040	4,590	-
Total Shpenzimet direkte per projekte	458,443	395,516

6. SHPENZIMET E PERSONELIT

	31 Dhjetor 2020 (në EUR)	31 Dhjetor 2019 (në EUR)
SOE 03	95,166	103,371
SOE 04	5,444	-
KOS 031	34,802	-
KOS 028	-	19,469
Total shpenzimet e personelit	135,412	122,841

7. SHPENZIMET OPERATIVE

	31 Dhjetor 2020 (në EUR)	31 Dhjetor 2019 (në EUR)
SOE 03	-	366
ALB 002	3,000	176
KOS 028	-	1,016
Total Shpenzimet operative	3,000	1,558

Help - Hilfe zur Selbsthilfe e.V Zyra Përfaqesuese në Kosovë
Shënimet e Pasqyrave Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

8. SHPENZIMET E TRANSPORTIT

	31 Dhjetor 2020 (në EUR)	31 Dhjetor 2019 (në EUR)
SOE 01	-	45
SOE 03	14,244	18,897
ALB 002	473	2,054
KOS 031	2,506	-
KOS 028	-	3,047
KOS 001	8,100	16,500
Total Shpenzimet e transportit	25,323	40,543

9. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	31 Dhjetor 2020 (në EUR)	31 Dhjetor 2019 (në EUR)
SOE 01	-	216
SOE 03	29,363	30,432
SOE 04	171	-
ALB 002	262	1,543
KOS 031	7,370	-
KOS 028	-	7,842
KOS 001	122	232
XKX 036	134	-
XKX 040	5,410	-
Total Shpenzimet administrative	42,832	40,265

10. NGJARJET E MËPASME

COVID-19

Periudha disamujore e mbylljes së organizatës ose reduktimit të aktiviteteve mund të ketë efekt në operimet e organizatës në të ardhmen.

Në kohën e përgatitjes së raportit të auditimit, organizata ka vazhduar operimet dhe ka qenë në gjendje t'i përmbushë obligimet, për këtë arsye raporti është përgatitë duke përdorur bazën e vijimësisë.